

MJEDISI EUROPIAN

GJENDJA DHE PERSPEKTIVAT 2015 (SOER 2015)

Vlerësim i integruar i gjendjes së mjedisit në Europë



Mjedisi European - Gjendja dhe Perspektivat 2015, jep një vlerësim të plotë të gjendjes së mjedisit në nivel evropian, përcakton trendet dhe prespektivat, duke i vendosur ato në kontekst global. Ky raport jep informacion mbi shkallën e implementimit të politikave mjedisore europiane për periudhën midis 2015-2020, si dhe analizon mundësitë e modifikimit të politikave ekzistuese (si dhe bazën e të dhënave dhe njohurive të përdorura për hartimin e tyre) me qëllim arritjen e objektivit të vendosur nga Bashkimi Evropian për 2050 -en: "të jetojmë mirë brenda kufijve të planetit tonë".

SOER 2015, përmban informacion mjedisor objektiv, të besueshëm dhe të krahasueshëm. Ai mbështetet në të dhënat dhe informacionet mjedisore që AEM (Agjencia Evropiane e Mjedisit) dhe EIONET disponon (EIONET/ Rrjeti Evropian i Informacionit dhe Vëzhgimit Mjedisor i përbërë nga 39 vende evropiane përfshirë edhe vendet e Ballkanit Perëndimor)

Raporti me gjithë elementet e tij: analiza e gjerë në nivel global, evropian, rajonal, si dhe analizat e bëra për gjithë vendet, së bashku me raportin përmbledhës (Synthesis Report) dhe ato të mega trendeve globale mjedisore (Global Megatrends), perben një burim informacioni dhe njohurish me mjaft vlerë për të gjithë aktoret e interesuar dhe të përfshirë në proceset e lidhura me mjedisin dhe përmirësimin e tij në Europë.

SOER 2015 lancohet në 3 Mars 2015.



SOER 2015 Raporti Permbledhes (Synthesis Report)

Ky raport jep informacion mbi politikat e ardhshme mjedisore europiane ne pergjithesi si dhe implementimin e tyre gjate 2015-2020 ne vecanti. Ai perfshin gjithashtu nje reflektim mbi kontekstin global te mjedisit European, si dhe permban disa kapitujt qe paraqesin ne menyre te permbledhur gjendjen e mjedisit, trendet dhe perspektivat mjedisore ne Europe.

SOER 2015 Vleresimi i Megatrendeve Globale (Assessment of Global Megatrends)

Ky raport vlereson 11 trende globale me rendesi te vecante per mjedisin europian ne nje periudheafatgjate. Ne vleresimin qe ju behet forcave shtytese, trendeve dhe ndikimeve te tyre ne mjedisineuropian, qellimi eshte qe tju ofrohet nje baze e permiresuar te dhenash politikeberesve strategjik mjedisore Europiane.

Megatrendet Gobale :

Nje set me 11 permbledhje qe perfshin:

- 1-Ndryshimet e trendeve globale te popullimit
- 2- Drejt nje bote me urbane
- 3- Ndryshimi i kufijve te semundjeve dhe rreqiku ndaj epidemive
- 4-Pershpejtimi i zhvillimeve teknologjike
- 5- Rritje e vazhdueshme ekonomike ?
- 6- Nje bote multipolare ne rritje te vazhdueshme
- 7- Konkurenca globale per burime
- 8-Rritja e presioneve mbi ekosistemet
- 9-Intensifikimi i pasojave te ndryshimeve klimatike
- 10-Ritja e niveleve te ndotjes se mjedisit
- 11- Diversifikimi i qasjeve ndaj qeverisjes

Permbledhje Europiane:

Nje set me 25 permbledhje tematike qe perfshin tematikat e meposhtme:

- 1- Bujqesia
- 2- Ndotja e Ajrit
- 3- Biodiversiteti
- 4- Ndikimet e Ndryshimeve Klimatike dhe Masat Adaptuese
- 5- Konsumi
- 6- Energjia
- 7- Pyjet
- 8- Cilesia e Ujerave te Embla
- 9- Ekonomia e gjelber
- 10-Shendeti dhe Mjedisi
- 11-Sistemi Hidrologjik dhe Menaxhimi i Qendrueshme i Ujerave
- 12-Industria
- 13- Sistemi i Tokave
- 14- Mjedisi Detar
- 15- Aktivitetet Detare
- 16-Zbutja e Ndikimit te Ndryshimeve Klimatike
- 17-Pasuria Natyrore dhe Sherbimet e Ekosistemeve
- 18- Zhurmat
- 19- Eficenca e Burimeve
- 20-Tokat
- 21-Ajri dhe Klima
- 22-Turizmi
- 23-Transporti
- 24- Sistemet Urbane
- 25- Mbetjet

Analize krahasimore midis vendeve:

Nje set me 9 permbledhje te cilat trajtojne:

- 1- Bujqesia- fermat organike
- 2- Ndotja e ajrit- shkarkimet e elementeve ndotes te caktuar
- 3- Biodiversiteti - Zonat e Mbrojtura
- 4- Energjia- konsumi i energjise dhe energjite e rinovueshme
- 5- Cilesia e ujerave te embel - nutrientet ne lumenj
- 6- Zbutja e pasojave te ndryshimeve klimatike - gazet sere
- 7-Eficenca e burimeve-eficenca dhe produktiviteti i burimeve dhe materialeve
- 8- Transporti - kerkesa e pasagjereve per transport dhe menyra e shprendarjes se tyre
- 9- Mbetjet - gjenerimi i mbetjeve te ngurta urbane dhe menaxhimi tyre

Keto krahasime bazohen ne te dhena per tregues te njejte mjedisore te aplikuar ne shume vende europiane dhe jane te lidhur me informacionet e treguesit e cdo vendi .

Vende dhe Rajone

Nje set me 39 permbledhje te cilat ne menyre te sintetizuar paraqesin gjendjen e mjedisit ne :

- 33 vendet anetare te EEA-se
- 6 vendet bashkepunuese te Ballkanit Perendimor

Perveç kesaj, 3 permbledhje bejne nje analize te pergjithshme te sfidave kryesore mjedisore te rajoneve te perzgjedhura, qe shtrihen pertej Europes te trajtuara edhe ne Programin e 7-te Mjedisor te Punes (7th Environment Action Programme) se Bashkimit European :

- Rajoni Arktikut
- Rajoni i Detit te Zi
- Rajoni i Detit Mesdhe

Gjithe permbledhjet e mesiperme do te jene te disponueshme ne platformen online prej dates 4 Mars 2015 ne : eea.europa.eu/soer

Kopjet e printuara do te porositen nepermjet sherbimit te ofruar nga regjistrimi ne: eea-subscriptions.eu/subscribe

MJEDISI EUROPIAN, Gjendja dhe Perspektivat 2015 (SOER 2015) eshte pergatitur si rezultat i nje iniciative te perbashket bashkepunimi te ngushte te 33 vendeve anetare dhe 6 vendeve bashkepunuese me AEM - ne dhe Komisionin European. Perveç kesaj, disa institucione nderkombetare jane perfshire ne nje proces rishikimi e vleresimi te ketij botimi.

Agjencia Europiane e Mjedisit (AEM) eshte nje agjenci e Bashkimit European. Objektivi i saj eshte mbeshtetja e zhvillimit te qendrueshem dhe ndihmes se nevojshme me qellim arritjen e rezultateve domethenese ne drejtim te permiresimit te mjedisit ne Evrope, nepermjet marjes se masave te nevojshme, besueshme dhe ne kohen e duhur, nga ana e politikeberesve dhe publikut gjithashtu.

Per me shume informacion vizitoni : eea.europa.eu